

KOMITETIT SHQIPTAR I HELSINKIT

KODI ZGJEDHOR, 2003¹

(VËSHTRIM KRITIK)

NIAZI JAHO

Këshilltar Ligjor i Komitetit Shqiptar të Helsinkit

¹ Edhe pse ky punim është botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në të shprehet qëndrimi i autorit dhe jo detyrimisht edhe ai i Komitetit

Përmbajtja

Parathënie

Dy fjalë për autorin e këtij punimi

Hyrje

Kreu I

Vështrim kritik i Kodit të ri zgjedhor

1.1 Komisionet e zgjedhjeve

1.2 Listat e zgjedhësve

Kreu II

Vërejtje dhe sugjerime për dispozita të veçanta të Kodit zgjedhor

PARATHËNIE

Zhvillimet politike pas viteve '90, ndërtimi i sistemit pluralist, nevoja e garantimit të lirive dhe të drejtave të njeriut shtruan si domosdoshmëri hartimin e një legjislacioni demokratik dhe krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për realizimin në praktikë të këtyre të drejtave. Vend të veçantë ndër këto të drejta zënë të drejtat politike. Në këtë drejtim janë shënuar zhvillime pozitive. Miratimi i Kushtetutës së vitit 1998, hartimi i Kodit zgjedhor, krijimi i institucioneve përkatëse për menaxhimin e procesit zgjedhor janë disa arritje pozitive në fushën e realizimit të të drejtave politike, sidomos të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Por realizimi i këtyre të drejtave varet jo vetëm nga ekzistenca e ligjeve që i sanksionuan ato dhe që parashi-kuan të gjitha instrumentet që mundësojnë realizimin e tyre në praktikë, por edhe nga vullneti politik i partive politike dhe i institucioneve që ngarkohen me ligj për të organizuar dhe për të drejtuar procesin zgjedhor. Në këtë proces, rol të rëndësishëm luajnë edhe vetë zgjedhësit, të cilët jo vetëm duhet të ushtrojnë të drejtat e tyre, por edhe të kontribuojnë në zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike. Çdo zgjedhës, në mënyrë individuale ose i bashkuar në organizata ose grupime, mund të kontribuojë në zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara.

Përvoja e këtyre viteve ka treguar se shoqëria civile shqiptare, sidomos organizatat e të drejtave të njeriut, kanë luajtur rol të rëndësishëm në ecurinë e procesit zgjedhor në Shqipëri. Kontributi i tyre ka qenë dhe vazhdon të jetë i nevojshëm edhe për proceset zgjedhore të ardhshme. Një nga fushat ku shoqëria civile ka kontribuar është edhe ajo e përmirësimit të legjislacionit.

Kodi zgjedhor i ri, i hartuar edhe me kontributin e përfaqësuesve të partive politike, ishte një përpjekje pozitive e shqiptarëve për të përmirësuar procesin zgjedhor. Ligji hartohet për t'u zbatuar, por mosrespektimi i tij çon në shkelje serioze të lirive dhe të drejtave të shtetasve.

Me gjithë progresin e bërë në këtë drejtim, proceset zgjedhore në Shqipëri më parë si dhe zgjedhjet e 12 tetorit të viti 2003 treguan se ende ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Mungesa e vullnetit politik për të kontribuar në zhvillimin sa më korrekt të zgjedhjeve, dobësia e institucioneve dhe e hallkave të tjera zgjedhore të ngarkuara me ligj për të menaxhuar proceset zgjedhore në Shqipëri, mosrespektimi ose mosbesimi i/ndaj institucioneve që drejtojnë dhe menaxhojnë zgjedhjet diktojnë nevojën e ushtrimit të vëzhgimit të procesit zgjedhor nga vëzhgues objektivë, jopartiakë dhe profesionistë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, organizata e parë e të drejtave të njeriut, me përvojë në fushën e vëzhgimeve në përgjithësi dhe në atë të zgjedhjeve në veçanti, ka dhënë kontributin e vet në përmirësimin e legjislacionit zgjedhor, në njohjen dhe respektimin e tij gjatë proceseve zgjedhore, në zhvillimin e proceseve zgjedhore, në sensibilizimin e publikut për rolin e tij në këtë proces dhe ka reaguar ndaj shkeljeve të lirive dhe të drejtave të shtetasve gjatë fazave të ndryshme të procesit zgjedhor.

Edhe gjatë zgjedhjeve të 12 tetorit 2003, KSHH-ja ka vëzhguar përgatitjen e procesit zgjedhor dhe ecurinë e tij. Për vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve, KSHH-ja aktivizoi 106 vëzhgues afatgjatë të cilët vëzhguan aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Mjaft prej problemeve të vëna re në këto zgjedhje e kishin burimin tek Kodi zgjedhor.

Duke qenë se KSHH-ja nuk kritikon vetëm shkeljet e të drejtave të njeriut, por edhe rekomandon përmirësimet e nevojshme të ligjeve dhe të praktikave të zbatimit të tyre, nëpërmjet këtij botimi të shkruar prej këshilltarit ligjor të tij synon të trajtojë disa probleme ligjore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në proceset zgjedhore dhe në respektimin e të drejtave të shtetasve në këto procese.

Trajtimet e problemeve të paraqitura në këtë botim janë bazuar në përvojën e gjatë dhe të pasur të autorit të këtij botimi, në analizën e problemeve të konstatuara nga vëzhguesit e KSHH-së si dhe në vlerësimin që KSHH-ja u ka bërë proceseve zgjedhore të zhvilluara kohët e fundit në Shqipëri. Megjithatë duhet të theksojmë se autori i këtij punimi ka qenë i lirë të shprehë mendimet dhe vlerësimet e tija, pavarësisht nga fakti nëse ato mund të jenë të ndryshme me mendimin e anëtarëve të tjerë të kësaj organizate.

KSHH-ja përfiton nga rasti të falënderojë të gjithë vëzhguesit e vet për punën e palodhur të tyre, stafin e KSHH-së të angazhuar në organizimin e vëzhgimeve të proceseve zgjedhore dhe në veçanti autorin e këtij botimi për kontributin që jep në përmirësimin e legjislacionit zgjedhor.

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme që mund të ekzistojnë rreth problemeve të trajtuara në këtë botim, KSHH-ja vlerëson faktin që ky botim është një kontribut i veçantë për diskutime të mëtejshme të tyre në rrethe juristësh dhe specialistësh të të drejtave të njeriut. Shpresojmë që ky botim të nxitë debatet dhe diskutimet rreth Kodit zgjedhor, me qëllim që të arrihet përmirësimi i tij dhe zhvillimi i zgjedhjeve të ndershme, të drejta dhe demokratike.

KSHH-ja përfiton nga rasti të falënderojë Komitetit Suedez të Helsinkit për mbështetjen financiare të dhënë për realizimin e këtij botimi.

Dy fjalë për autorin e këtij punimi

Niazi Jaho, jurist në profesion, është anëtar i Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe këshilltar ligjor i këtij komiteti, anëtar bordi i QSHDNJ-së, kryeredaktor i revistës “Të drejtat e njeriut”, anëtar i Komisionit Kombëtar të Refugjatëve dhe këshilltar ligjor (i jashtëm) i Kuvendit të Shqipërisë.

Një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së tij e zë studimi i çështjeve të ndryshme në fushën kushtetuese, në atë të procedurës penale dhe të legjislacionit penitenciar. Prej disa vitesh ka dhënë ndihmesë të dukshme në përmirësimin e mjaft projektligjeve, sidomos në fushën e drejtësisë, të mbrojtjes së të drejtave të njeriut etj.

Z. Jaho është autor i shumë shkrimeve, referateve dhe kumtesave dhe, si jurist, i pranishëm me mendimin kritik dhe polemikat e tija konstruktive në seminare, konferenca, tryeza ekspertësh si dhe në median e shkruar dhe atë elektronike. Në shkrimet e tija spikat mbrojtja e parimeve kushtetuese, objektiviteti dhe argumenti, respektimi i mendimit alternativ, madje edhe i mendimit të kundërt, pozicioni i specialistit të paanshëm dhe pa ngarkesa politike.

Prej disa vjetësh, Z. Niazi Jaho është angazhuar me problemet që kanë të bëjnë me legjislacionin zgjedhor. Është autor i dy botimeve për Kodin zgjedhor të vitit 2000: botimi i parë është për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore dhe botimi i dytë, për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë. Në këto punime trajtohen çështje të rëndësishme për Kodin zgjedhor si dhe jepen sqarime për probleme të diskutueshme në këtë fushë.

Edhe ky punim, botimi i tretë në këtë fushë i këtij autori, ka të bëjë me Kodin e ri zgjedhor, të miratuar në vitin 2003. Në trajtimin e problemeve në këtë punim autori është bazuar në përvojën e zgjedhjeve të zhvilluara në Shqipëri si edhe në praktikën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 12 tetorit 2003. Për problemet e diskutueshme, nga njëra anë ai mban qëndrim kritik, por, nga ana tjetër, shprehet edhe për mënyrat ose variantet e mundshme për përmirësimin e Kodit zgjedhor ekzistues.

Ky punim mund të vlejë edhe si material për diskutimet dhe debatet që mund të zhvillohen në të ardhmen për këtë çështje.

HYRJE

Pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (nëntor 1998), në vitin 2000, u miratua Kodi zgjedhor. Në këtë Kod përcaktoheshin rregullat për votimin e zgjedhjeve të Kuvendit, të organeve të qeverisjes vendore dhe referendumeve. Në frymën dhe zbatimin e Kushtetutës, neni 3 i këtij Kodi përcaktonte parimet e përgjithshme:

- a) Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë.
- b) Çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.
- c) Zgjedhësit ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
- d) Zgjedhësit janë të barabartë në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
- e) Ndarja e zonave zgjedhore bëhet duke përfshirë në secilën prej tyre një numër afërsisht të barabartë zgjedhësish.
- f) Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor ose të një alternative referendare.
- g) Subjektet zgjedhore janë të lira të bëjnë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.
- h) Komisionet zgjedhore i përmbushin funksio-net e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente.

Kodi i mësipërm, i miratuar në maj të vitit 2000, pësoi ndryshime në maj të 2001-së, ndërsa me ligjin nr. 9087, datë 19.VI.2003, u shfuqizua në tërësi dhe u miratua Kodi i ri. Pra, siç shihet, Kodi zgjedhor i mëparshëm u shfuqizua brenda një kohe të shkurtër (maj 2000 – qershor 2003).

Sipas mendimit tonë, arsyet kryesore ishin:

- ☞ Më 24 qershor 2001, në bazë të Kodit zgjedhor të vitit 2000, u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Në këto zgjedhje u vërtetuan disa shkelje dhe çrregullime që pjesërisht u konsideruan serioze.
- ☞ Fill pas zgjedhjeve të mësipërme, më 12 tetor 2001, në shtypin tonë u botua raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it¹ ku, krahas arritjeve, vihej theksi edhe në disa shkelje të ligjit. Në këtë raport thuhej se zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 krijuan mundësi për një konsolidim të mëtejshëm të standardeve demokratike pas zgjedhjeve të pushtetit vendor, të zhvillura në tetor të vitit 2000. Megjithëkëtë, po në këtë raport, duke pasur parasysh shkeljet e vërtetuara, sidomos për shkak të mungesës së vullnetit politik, u bënë edhe mjaft rekomandime të cilat synonin përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor. Midis tyre rekoman-dohej krijimi i një komisioni parlamentar dypalësh (pozitë – opozitë).
- ☞ Ndryshimet që duhet t'i bëheshin Kodit zgjedhor ishin relativisht të shumta. Pikërisht për këtë arsye, shfuqizimi në tërësi i Kodit të mëparshëm u pa si më i përshtatshëm edhe nga pikëpamja e përdorimit praktik të ligjit.

¹ Gazeta "Albania", 12 tetor 2001

Në zbatim të rekomandimeve që paraqiteshin në raportin e OSCE/ODIHR-it për krijimin e komisionit të mësipërm, Kuvendi mori tri vendime: vendimin nr.15, datë 21.I.2002, i cili u shfuqizua me vendimin nr.36 datë 16.V.2002 dhe, më në fund, vendimi nr.39, datë 23.V.2002, “Për një shtesë në vendimin e Kuvendit, nr.36, datë 16.V.2002, “Për krijimin e Komisionit Parlamentar për Shqyrtimin dhe Zbatimin e Rekomandimeve të OSCE/ODIHR-it për Zgjedhjet Parlamentare të Vitit 2001”.² Në vendimin e fundit përcaktohej përbërja e Komisionit prej 16 personash (8 nga pozita dhe 8 nga opozita).

Megjithëse Komisioni u ngrit qysh në janar të 2002-së, deri në maj të vitit 2002 ai thuajse nuk funksionoi. Ai punoi me hope edhe pas muajit maj 2002, megjithëse në vendimin nr.36, që përmendëm më lart, thuhej se Komisioni do të fillonte nga puna ditën e miratimit të këtij vendimi dhe do të përfundonte brenda 2 muajve nga krijimi i tij.

Faktorët e kësaj zvarritjeje kanë qenë të ndryshëm, por mendojmë se ishin kryesisht të natyrës politike. Në të vërtetë, Komisioni arriti të hartojë projektin e ndryshimeve të Kodit zgjedhor në muajin maj 2003, ndërsa miratimi i Kodit u bë më 19 qershor të vitit 2003³, domethënë më pak se katër muaj para 12 tetorit të këtij viti, datë e caktuar për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore. Kodi zgjedhor u miratua me konsensusin e partive politike, sidomos të dy partive politike më të mëdha, të pozitës dhe të opozitës, dhe kjo u konsiderua pozitive.

Para miratimit të Kodit u hodhën disa ide që kishin të bënin me amendime kushtetuese, por që ato, ose nuk gjetën mbështetje, ose u lanë për t’u diskutuar në një kohë të mëvonshme. Si të tilla mund të përmendim:

1. Në raportin e OSCE/ODIHR-it rekomandohej, veç të tjerave, që zgjedhjet të ishin me një raund. Duke u nisur nga kjo, u diskutua çështja e ndryshimit të nenit 64 të Kushtetutës me arsyetimin se shprehja “në raundin e parë të zgjedhjeve” nënkuptonte se duhej të kishte edhe raund të dytë. Në të vërtetë kjo pikëpamje nuk u mbështet, sepse neni 64 i Kushtetutës (pikat 2 dhe 3) nuk e bën të detyrueshëm raundin e dytë. Si rrjedhim, zgjedhjet me një raund nuk binin ndesh me dispozitën e mësipërme kushtetuese.
2. Partitë politike, sidomos dy partitë e mëdha, ngritën çështjen e rritjes së përqindjes së votave që duhej të merrnin partitë për të përfituar nga lista shumemërore. Në pikën 3 të nenit 64 të Kushtetutës thuhet: “Partitë që marrin më pak se 2,5 për qind dhe koalicionet e partive që marrin më pak se 4 për qind të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve nuk përfitojnë nga listat shumemërore përkatëse”.

Mirëpo edhe kjo pikëpamje nuk gjeti mbështetje. Si argument u paraqitën këto arsye:

- a) Duke pasur parasysh kushtet e vendit tonë dhe, në mënyrë të veçantë, shkallën e emancipimit politik, shmangia nga veprimtaria parlamentare e disa partive të vogla nëpërmjet përqindjes që përmendëm më sipër, do të bënte sunduese dy partitë më të mëdha.
- b) Partitë e vogla në Shqipëri do të shërbenin edhe në të ardhmen për krijimin e ekuilibrit politik dhe të aleancave, gjë që do të mundësonte në mënyrë të

² Fletore zyrtare, nr. 21, qershor 2002

³ Kodi zgjedhor, botim i veçantë, korrik 2003, shpallur me dekretin nr.3868, datë 30.VI.2003 të presidentit të Republikës së Shqipërisë

veçantë miratimin e ligjeve që kërkojnë votim të cilësuar. Gjithashtu, ato do të ndikojnë pozitivisht edhe në parandalimin e krizave.

3. Partitë e vogla shtruan çështjen e ndryshimit të sistemit të zgjedhjeve duke kërkuar sistemin me prirje proporcionale. Ky propozim do të kërkonte ndryshimin e pikës 1 të nenit 64 të Kushtetutës ku thuhet: “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë. 100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore me numër të përafërt zgjedhësish, 40 deputetë zgjidhen nga lista shumëemërore të partive dhe/ose koalicioneve të partive sipas renditjes në to”.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk u zhvillua ndonjë diskutim ose debat i gjithanshëm dhe i studiuar ku të paraqiteshin, si epërsitë, edhe mangësitë e sistemit proporcional. Veç kësaj, sipas mendimit tonë, nuk do të ishte e rekomandueshme që një problem kaq i rëndësishëm të zgjidhej në prag të zgjedhjeve të 12 tetorit 2003. Megjithatë, kjo mbetet një çështje që, në një kohë të përshtatshme, mund të shtrohet duke paraqitur argumente bindëse se çfarë sistemi zgjedhor mund të ishte më i përshtatshëm për kushtet e vendit tonë.

Kreu I

VËSHTRIM KRITIK I KODIT TË RI ZGJEDHOR

Do të ishte gabim të injoroheshin të rejat pozitive që përmban Kodi i ri zgjedhor, i miratuar më 19 qershor 2003. Si të tilla mund të përmendim dispozitat ku bëhet fjalë për subjektet e parimit të moscenimit të zgjedhjeve, të ndalimit të përdorimit të burimeve në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve, të emërimit, detyrat e nëpunësit ndërlidhës etj. Të një rëndësie të veçantë janë dispozitat ku flitet për mbledhjet dhe vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për aktet e KQZ-së dhe hyrjen e tyre në fuqi, për ankimin në rrugë administrative të vendimeve të komisioneve zgjedhore dhe sidomos për procedurën e shqyrtimit të tyre nga KQZ-ja. Duhet konsideruar pozitiv, gjithashtu, fakti që, për herë të parë në legjislacionin tonë zgjedhor, krijohet Kolegji Zgjedhor i gjykatës së apelit sipas një procedure të caktuar në këtë Kod, duke shkarkuar në këtë mënyrë Gjykatën Kushtetuese nga shqyrtimi i ankesave që nuk i takonin. Në Kodin e ri zgjedhor janë parashikuar në mënyrë të detajuar dispozita për një fushatë zgjedhore të ligjshme, të ekuilibruar dhe të kontrollueshme. Këtë e gjejmë në nenin 136 (Fushata zgjedhore në radiotelevizionin publik), në nenin 137 (Edicionet informative të radiotelevizionit publik), në nenin 138 (Orari i transmetimeve), në nenin 140 (Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private), në nenin 142 (Monitorimi i fushatës zgjedhore). Në kuadër të ndryshimeve të bëra, dhjetë ditë para fillimit të periudhës zgjedhore, KQZ-ja ngrinte një bord me detyrë zbatimin e dispozitave të Kodit zgjedhor për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private.

Në Kodin e ri zgjedhor janë përcaktuar, gjithashtu, edhe dispozita ku flitet për përdorimin e forcave dhe të strukturave të posaçme gjatë gjithë periudhës zgjedhore. Dihet se, për zbatimin e kësaj dispozite, në momentin kur Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ ku bëhej fjalë për këtë çështje, opozita shprehu shqetësime. Por, më vonë, debatet u sheshuan, aq më tepër sepse qëndrimi i organeve të rendit gjatë zgjedhjeve të 12 tetorit u konsiderua korrekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore, gjë që u pranua nga të gjitha forcat politike.

E rëndësishme në Kodin zgjedhor është edhe pjesa e trembëdhjetë e tij (Përgjegjësitë dhe sanksionet) ku bëhet fjalë për përgjegjësinë e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve, braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, sanksionet administrative në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra sipas këtij Kodi, sanksionet për shkelje të parimeve që përcaktohen në nenet 3, 4 dhe 5 të këtij Kodi etj.

Megjithëkëtë, kemi mendimin se disa dispozita të Kodit zgjedhor bien ndesh me Kushtetutën dhe me frymën e saj, ndërsa ka edhe dispozita të paqarta, të pasakta ose jo të plota që, në praktikë, mund të shoqërohen me keqinterpretime dhe me pasoja të

dëmshme, gjë që u vërtetua edhe në zgjedhjet e 12 tetorit 2003. Ne do të ndalemi në ato çështje që mendojmë se janë të rëndësishme edhe pse mund të jenë të diskutueshme. Duke pasur parasysh kohën relativisht të shkurtër në të cilën u angazhuam për trajtimin e këtij problemi, nuk pretendojmë për ndonjë studim të thelluar dhe të gjithanshëm. Në këtë punim nuk kemi përfshirë dispozitat e Kodit zgjedhor në të cilat bëhet fjalë kryesisht për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe referendumet, megjithëse, siç dihet, ato janë pjesë e rëndësishme e Kodit zgjedhor. Kjo, sigurisht, do të kërkonte një kohë më të gjatë duke pasur parasysh, si përvojën pozitive, edhe atë negative. Ndoshta edhe vetë zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të sillnin argumente për të arritur në përfundime më të drejta edhe për pjesët e tjera të këtij Kodi.

Zgjedhjet e 12 tetorit të vitit 2003, për organet e qeverisjes vendore, edhe pse në disa drejtime shënuan një hap përpara, krijuan disa shqetësime që, sipas mendimit tonë, kanë të bëjnë jo vetëm me mungesën e vullnetit politik, por edhe me disa defekte në Kodin e ri. Për këtë, veç të tjerave, do të ndalemi sidomos në dy çështje që i konsiderojmë thelbësore:

- Ngritjen, rolin dhe funksionimin e komisioneve të zgjedhjeve.
- Listat e zgjedhësve.

1.1 KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

Veç Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) që ishte i ngritur, në zgjedhjet e 12 tetorit 2003, u ngritën dhe funksionuan komisionet zgjedhore të qeverisjes vendore (KZQV-të) dhe komisionet e qendrave të votimit (KQV-të). Në Kodin zgjedhor parashikohen gjithashtu edhe komisionet e zonave zgjedhore (KZZ-të).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja)

KQZ-ja është organ kushtetues. Sipas nenit 153 të Kushtetutës, KQZ-ja është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre. Neni 154 i Kushtetutës përcakton përbërjen e KQZ-së. Në të thuhet se ky komision përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat 7-vjeçar. Dy anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, 2 nga presidenti i Republikës dhe 3 anëtarë të tjerë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Anëtarësia në vetë Komisionin nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe politike. Përbërja e KQZ-së përtëritet çdo tre vjet sipas procedurës së përcaktuar në ligj. Në nenin e mësipërm thuhet, gjithashtu, se anëtari i KQZ-së gëzon imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Në zbatim të nenit 154 të Kushtetutës, në nenin 17 të Kodit zgjedhor të shfuqizuar përcaktohej procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së. Kështu, Kuvendi, në bazë të propozimeve të Byrosë së Kuvendit, zgjidhte 2 anëtarë të KQZ-së; presidenti, pas konsultimeve me grupe që përfaqësonin një spektër të gjerë të shoqërisë, emëronte 2 anëtarë; Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD-ja), në bazë të propozimeve të konferencës gjyqësore, kombëtare dhe të kandidaturave individuale, zgjidhte 3 anëtarë, me votim të fshehtë. Të gjitha propozimet dhe kandidaturat duhet të bëheshin publike.

Të tria organet e mësipërme (Kuvendi, Presidenti dhe KLD-ja), në zgjedhjen e anëtarëve të KQZ-së duhet të kishin parasysh kriteret (cilësitë e anëtarëve) e përcaktuara në nenin 16 të Kodit të shfuqizuar.

Përmbajtja e neneve 153 dhe 154 të Kushtetutës dhe në zbatimin e tyre edhe nenet 16 dhe 17 të Kodit të shfuqizuar që përmendëm më lart, janë plotësisht të mjaftueshme për të na bindur se ligjvënësi ka dashur të krijojë një KQZ me cilësitë e një organi kushtetues të pavarur, të paanshëm dhe jashtë ndikimeve politike. Në qoftë se ligjvënësi do të donte që ky organ, në përbërjen e tij, të ishte i balancuar politikisht, domethënë të ngrihej në bazë të propozimeve të partive përkatëse politike, do ta kishte shprehur këtë në Kushtetutë (në nenin 154).

Për sa i përket organizimit dhe funksionimit të KQZ-së, si organ Kushtetues, ato zgjidhen me ligj të veçantë, siç është Kodi zgjedhor, i miratuar me votim të cilësuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Disa parti politike, edhe para miratimit të Kodit të ri, e kishin ngritur çështjen e balancimit politik dhe të KQZ-së. Ky problem u bë objekt diskutimi dhe debati edhe gjatë hartimit të Kodit të ri zgjedhor dhe me konsensusin e të gjitha partive u arrit të miratohej neni 22 i Kodit zgjedhor në favor të pikëpamjes si duhet t'i zgjedhin presidenti edhe KLD-ja anëtarët e KQZ-së në bazë të propozimeve të partive politike përkatëse. Në të vërtetë, me konsensus u zgjidhën edhe mjaft çështje të tjera të këtij Kodi, pavarësisht se përfaqësuesit e disa partive të vogla paraqitën vërejtjet e tyre.

Mendojmë se përmbajtja e nenit 22 të Kodit zgjedhor nuk pajtohet me Kushtetutën dhe, si e tillë, duhet të shfuqizohet.

Neni 22 i Kodit zgjedhor thotë: "Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së, në bazë të propozimeve përkatëse të dy partive më të mëdha, të pozitës dhe të opozitës" dhe "Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh tre anëtarë të KQZ-së sipas kësaj procedure:

- a) Dy anëtarë të KQZ-së miratohen me nga dy kandidatura të propozuara përkatësisht nga dy partitë më të mëdha.
- b) Për kandidatin e tretë, Këshilli i lartë i Drejtësisë ndjek këtë procedurë: Dy grupet më të mëdha parlamentare propozojnë nga katër kandidatura me profesion jurist. Secili prej grupeve parlamen-tare përzgjedh dy nga katër kandidaturat e grupit tjetër. Katër kandidaturat e përzgjedhura i paraqiten Këshillit të Lartë të Drejtësisë për votim jo më vonë se 48 orë nga depozitimi i tyre". Edhe sikur të mos ishte kështu, balancimi politik që synon neni 22 i Kodit zgjedhor, në zgjedhjet e 12 tetorit 2003 nuk mund të arrihej, sepse do të kërkonte një periudhë kohe relativisht më të gjatë se ç'mund të mendohej ose të dëshirohej. Këtë e themi, sepse:
 - Disa anëtarë të KQZ-së ishin zgjedhur sipas Kodit të shfuqizuar (nenit 7) dhe mandati i tyre 7-vjeçar nuk mund të ndërpritej vetëm sepse, sipas nenit 22 të Kodit të ri, duhet të arrihej balancimi politik.
 - Propozimet partiake nuk mund ta detyronin presidentin e Republikës që, në emërimin e anëtarëve të KQZ-së, të zgjidhte personin që realizonte balancimin.
 - KLD-ja është organ kushtetues, i pavarur dhe që merr vendime kolegjiale. Sipas ligjit, atij mund t'i paraqiten propozime partiake, por, duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Kodit zgjedhor (cilësitë dhe kushtet që kërkojnë për të qenë anëtar i KQZ-së) si dhe procedurën e votimit të përcaktuar në nenin 22 të Kodit, ai zgjedh personat që i çmon të përshtatshëm, pavarësisht nga fakti nëse ata janë propozuar nga pozita apo nga opozita.

Ky qëndrim i ligjshëm i KLD-së shkaktoi reagime dhe akuza në adresë të tij, vetëm se zgjodhi si anëtar të KQZ-së jo nga ata të propozuar nga opozita, por nga ata të

propozuar nga pozita. Fillimisht u tha se KLD-ja veproi në kundërshtim me marrëveshjen partiake midis PD-së dhe PS-së, kur dihet se, megjithëse marrëveshjet në bazë konsensusi të partive politike në një demokraci pluraliste janë jo vetëm të nevojshme, por edhe të domosdoshme, në qoftë se ato nuk pasqyrohen në ligje, nuk mund të jenë të detyrueshme edhe për organet shtetërore. Pak më vonë u bënë deklarata se KLD-ja veproi në kundërshtim flagrant me ligjin, me nenin 22 të Kodit zgjedhor, por askush nuk ndërmoi ndonjë nismë për rivendosjen e ligjit të shkelur.

Në qoftë se vullneti politik, i shprehur në veprimtarinë parlamentare, domethënë në organin legjislativ, do të pranonte ose do të kërkonte variantin e një KQZ-je të balancuar politikisht, do të dilte nevoja të procedohej, ose duke amenduar nenin 154 të Kushtetutës, ose duke shfuqizuar nenet 153 dhe 154 të Kushtetutës dhe duke e lënë zgjidhjen e kësaj çështjeje me dispozita të Kodit zgjedhor, siç është vepruar me komisionet e tjera. Për mendimin tonë (për këtë do të flasim më poshtë), mund të diskutohej që edhe këto komisione të mos krijoheshin në bazë të propozimeve të partive politike.

Nga studimi i Kodit zgjedhor mendojmë se edhe disa dispozita të tjera bien ndesh me Kushtetutën dhe, konkretisht:

- a) Shkarkimi i anëtarit të KQZ-së, sipas nenit 24, pika 3 e Kodit zgjedhor, bëhet me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Kuptohet që, në këtë aspekt, ky votim i cilësuar ka pasur për qëllim që edhe anëtari i KQZ-së të barazohet me anëtarët e tjerë të organeve kushtetuese (Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë etj.). Mirëpo për anëtarët e këtyre organeve bëhet fjalë shprehimisht në Kushtetutë⁴ ku thuhet se shkarkimi i tyre bëhet me dy të tretat e Kuvendit, ndërsa për anëtarin e KQZ-së nuk thuhet gjë. Në këto kushte mendojmë se duhet zbatuar rregulli i caktuar në nenin 78 të Kushtetutës, pika 1, ku thuhet: “Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar”. Prandaj, anëtari i KQZ-së mund të shkarkohet me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës të deputetëve të Kuvendit dhe jo me dy të tretat e anëtarëve të tij.
- b) Në Kodin zgjedhor flitet edhe për procedurën që ndiqet në rastet e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë të anëtarit të KQZ-së (në raste të tilla, në pikën 2 të nenit 23 të Kodit zgjedhor thuhet se organi kompetent duhet të njoftojë menjëherë Gjykatën Kushtetuese, e cila jep ose jo pëlqimin).

Në nenin 24, pika 4, të Kodit zgjedhor thuhet se anëtari i KQZ-së mund të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimit të shkarkimit dhe se është kjo gjykatë që merr vendim nëse shkarkimi është i bazuar ose jo.

Dispozitat e mësipërme, siç duket, janë miratuar për ta barazuar anëtarin e KQZ-së me anëtarin e Gjykatës së Lartë meqë në nenin 154 të Kushtetutës thuhet se anëtari i KQZ-së gëzon imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Mirëpo, me një ligj organik, Gjykatës Kushtetuese nuk mund t'i shtohen kompetencat e përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë. Ndryshe është me anëtarët e Gjykatës së Lartë. Rastet e ndalimit dhe të arrestimit në flagrancë të një anëtarit të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 137 të Kushtetutës, duhet të shqyrtohen detyrimisht nga Gjykata Kushtetuese. Po kështu veprohet edhe për shkarkimin e tyre kur janë rastet e parashikuara në nenin 140 të Kushtetutës. “Argumenti” se edhe anëtari i KQZ-së

⁴ Nenet 128 dhe 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

- duhet të ketë një mbrojtje, siç e ka edhe anëtari i Gjykatës së Lartë, mendojmë se nuk është i bazuar. E themi këtë sepse imuniteti është garancia e paprekshmërisë nga ndjekja penale, pa autorizimin nga organi përkatës. Kjo e drejtë ose ky privilegj nuk mund të shtrihet a priori edhe në rastet e tjera të përmendura më lart.
- c) Në Kodin zgjedhor bëhet fjalë jo vetëm për shkarkimin e anëtarit të KQZ-së kur janë rastet e parashikuara në nenin 24 (germa “a” deri në germën “ë”), por edhe për mbarimin e parakoh-shëm të mandatit të tij (neni 25, pika 1, germa “a” dhe “b”). Në leximin e parë këto dispozita duken normale dhe të padiskutueshme. Megjithatë, e shohim të nevojshme ta trajtojmë këtë çështje, jo sepse dispozitat e mësipërme bien ndesh me Kushtetutën, por sepse Gjykata Kushtetuese, në një vendim të saj, ka mbajtur qëndrimin që e trajtojmë në vijim:

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 8270, datë 23.XII.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, veç të tjerave sepse në këtë ligj flitej edhe për rastet e shkarkimit dhe të mbarimit para afatit të mandatit të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjykata Kushtetuese e pranoi këtë kërkesë me arsyetimin se: “Mospërcaktimi në Kushtetutë i rasteve të shkarkimit apo mbarimit para kohe të mandatit nuk do të thotë se ato mund të zgjidhen me ligje organike” dhe, më poshtë: “... ligji “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, duke kufizuar rastet e shkarkimit të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit apo të mbarimit para kohe të mandatit, pa u shprehur në Kushtetutë, ka kapërcyer caqet e kësaj të fundit”.⁵

Në të njëjtin vendim, Gjykata Kushtetuese trajton edhe çështjen e imunitetit të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit që, sipas pikës 2 të nenit 165 të Kushtetutës, ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë (siç e ka edhe anëtari i KQZ-së që përmendëm më lart). Në vendimin e mësipërm të Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje thuhet: “Imuniteti ka të bëjë me mbrojtjen e një kategorie të caktuar zyrtarësh ... dhe ka si element përgjegjshmërinë për veprat penale dhe paprekshmërinë nga ndjekja penale...”, ndërsa “Palëvizshmëria në kuptimin kushtetues është element i garantimit të pavarësisë së organit dhe jo imunitetit. Ajo ka të bëjë me mbrojtjen nga shkarkimi nga detyra të zyrtarëve të lartë”.

Arsyetimi që jepet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se derisa në Kushtetutë nuk bëhet fjalë për shkarkimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe për mbarimin para afatit të mandatit të tij, nuk mund të përcaktohen në një ligj organik, nuk na duket i drejtë, sepse me anë të ligjeve në zbatim të Kushtetutës, mund të zërthehen dhe të konkretizohen çështje që nuk parashikohen shprehimisht në Kushtetutë (siç ndodh edhe në rastin e anëtarit të KQZ-së), mjaft që ato të mos bien ndesh me ndonjë dispozitë Kushtetuese ose me frymën e saj. Mirëpo mendimet ose kritikave individuale ndaj këtij ose atij vendimi gjyqësor mund të shërbejnë vetëm për diskutime ose debate të këtij problemi në aspektin doktrinar. I rëndësishëm është fakti se, në rastin konkret, që ka analogji me atë të anëtarit të KQZ-së, vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha organet, duke përfshirë këtu edhe legjislativin. Prandaj, Kuvendi i Shqipërisë, para miratimit të neneve 24 dhe 25 të Kodit zgjedhor, duhej të kishte parasysh edhe vendimin e mësipërm të Gjykatës

⁵ Vendimi nr.212, datë 29.X.2002, i Gjykatës Kushtetuese, Përmbledhje vendimesh 2001–2002, botim i vitit 2003, faqe 206.

Kushtetuese. Në kuadrin e ndryshimeve që mund t'i bëhen Kodit zgjedhor ekzistues, do të sugjerohet të bëhet ajo që nuk u bë në atë kohë.

- d) Në nenin 154 (pika 2) thuhet se përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përtëritet çdo tre vjet sipas procedurës së përcaktuar në ligj. Kjo procedurë përcaktohet në mënyrë të detajuar në Kodin e shfuqizuar⁶.

Kodi i ri zgjedhor, në zbatim të nenit 154 të Kushtetutës, duhej të përcaktonte procedurat e përtëritjes së këtij Komisioni. Në të vërtetë, në nenin 26 të Kodit zgjedhor, fjala “përtëritje” përdoret vetëm në titullin e tij, ndërsa, në fakt, nuk flitet për përtëritjen që kërkon Kushtetuta, procedura e së cilës, siç u përmend më lart, ishte përcaktuar qartë në nenin 25 të Kodit të mëparshëm. Dhe, konkretisht, në nenin 26 të Kodit të ri thuhet:

- Mandati i anëtarit të KQZ-së mbaron në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të shtatë pas zgjedhjes së tij.
- Anëtarët e rinj që zëvendësojnë anëtarët të cilëve u mbaron mandati, sipas pikës 1 të këtij neni dhe nenit 25 të këtij Kodi (është fjala për mbarimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së), zgjidhen jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit. Në periudhë zgjedhore zëvendësimi bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e mbarimit të mandatit.

Siç shihet, në nenin 26 të Kodit të ri bëhet fjalë vetëm për mandatin e anëtarit të KQZ-së dhe jo për përtëritjen çdo tre vjet në përbërjen e KQZ-së. Janë pikërisht këto arsye që mendojmë se kjo dispozitë duhet të shikohet edhe për faktin se titulli, pjesërisht, nuk i përgjigjet përmbajtjes së nenit të mësipërm.

☞ Komisionet e zonave zgjedhore (KZZ-të), komisionet e zgjedhjes së qeverisjes vendore (KZQV-të) dhe komisionet e qendrave të votimit (KQV-të)

Sipas Kodit zgjedhor, të tria këto komisione krijohen në bazë të propozimeve të partive politike përkatëse. Ky fakt është përdorur si një nga argumentet për të kërkuar apo për të justifikuar edhe krijimin e KQZ-së në bazë të propozimeve të paraqitura nga partitë politike. Për këto komisione nuk thuhet gjë në Kushtetutë, megjithëse në nenin 3, pika 8, të Kodit zgjedhor “Parime të përgjithshme”, theksohet: “Komisionet zgjedhore të parashikuara në këtë Kod përmbushin funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente”. Nga përmbajtja e dispozitës del e qartë se ligji kërkon paanësi nga të gjitha komisionet dhe jo vetëm nga KQZ-ja.

Praktika e zgjedhjeve të mëparshme, duke përfshirë këtu dhe zgjedhjet e 12 tetorit 2003, ka vërtetuar në mënyrë bindëse se, në shumë raste, anëtarët e komisioneve kanë mbrojtur interesat e ngushtë të partive që i kanë propozuar. Për anëtarët e këtyre komisioneve, autoriteti më i lartë nuk ka qenë ligji, por porositë dhe diktati partiak. Ky është konstatim që u evidentua në katër raportet paraprake të Misionit të Vëzhguesve të Huaj në zgjedhjet e qeverisjes vendore të 12 tetorit 2003 (MVZ) si dhe në raportin paraprak të vëzhgimit, të hartuar nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit.

Kështu, për shembull, në raportin interim 4, të periudhës 14–21 tetor 2003, të MVZ-së, midis të tjerave, thuhet: “Përfshirja e partive politike në procesin e numërimit dhe të tabulimit të rezultateve ishte shumë më e madhe nga sa parashikohet në Kodin zgjedhor. Partitë udhëzojnë përfaqësuesit e tyre në komisionet zgjedhore në të gjitha

⁶ Neni 25 i Kodit të shfuqizuar

nivelet për të vonuar ose për të sfiduar rezultatet” dhe, më poshtë: “Tabulimi i rezultateve është ndërprerë dhe vonuar në nëntë nga 11 minibashkitë e Tiranës. Misioni i Vëzhguesve të Huaj ka vëzhguar vonesa të qëllimshme ose pengesa të procedurave nga ana e pjesëtarëve të KZQV-ve, si për shembull, bllokimi i miratimit të procesverbalit të rezultateve që kërkon shumicë të cilësuar vote. Në shumë raste, anëtarët e komisioneve kanë dhënë dorëheqjen ose nuk kanë marrë pjesë në takimet e komisionit. Gjithashtu, Misioni i Vëzhguesve të Huaj ka konfirmuar se vonesat kanë ardhur kryesisht nga veprimet e marra nga anëtarë të KZQV-ve që përfaqësojnë Partinë opozitare Demokratike (PD)”.

Veç sa më sipër, gjatë transmetimeve televizive të mbledhjeve të komisioneve ka tërhequr vëmendjen fakti i debateve politike brenda KZQV-ve, mosmarrë-veshjet me prirje partiake dhe politike midis anëtarëve, sidomos në Tiranë, intervistat e kryetarëve, zëvendëskryetarëve apo të anëtarëve të komisioneve, pa përfunduar procesi zgjedhor etj. Tipik, por domethënës, është rasti kur në mbledhjen publike të KQZ-së, kandidati për Bashkinë e Tiranës, që nuk pajtohej me procedurën e ndjekur nga KQZ-ja lidhur me ankesën e paraqitur prej tij, iu drejtua dy anëtarëve të KQZ-së me fjalët: “Në emër të partisë, ju bëj thirrje të largoheni nga Komisioni”!

Këto fakte dhe shumë të tjera, që në kuadrin e këtij punimi relativisht të përmbledhur është vështirë të përmenden, na bëjnë të shtrojmë, të paktën për diskutim, çështjen: mos vallë del nevoja që edhe këto komisione të mos ngrihen në bazë të propozimeve partiake?

Ne e kuptojmë rëndësinë që ka vullneti politik. Jemi të ndërgjegjësuar se në kushtet e një shkalle më të lartë emancipimi, e zbutjes së atmosferës politike midis partive politike, ndoshta ndikimi partiak në këto komisione do të ishte më i paktë ose më pak i ndjeshëm, por realiteti duhet vlerësuar ashtu siç është në të vërtetë dhe jo ashtu siç dëshirojmë të jetë.

Në datën 2 dhjetor 2003, Kolegji Zgjedhor i gjykatës së apelit në Tiranë vendosi të deklarojë të pavlefshëm rezultatin e nxjerrë nga 130 qendra votimi të qytetit të Tiranës. Ky vendim është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim. Arsyet konkrete përse zgjedhjet për këto qendra votimi u shpallën të pavlefshme nuk i dimë, sepse nuk jemi njohur me pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Por, me siguri, Kolegji Zgjedhor ka arritur në përfundimin se në këto qendra votimi ka pasur shkelje ligjore të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e shpallur me vendim të KQZ-së.

Shkeljet e ligjit mund të jenë bërë si nga KQV-të edhe nga KZQV-të, por, duke pasur parasysh një shtrirje relativisht kaq të gjerë, mendojmë se ky është një tregues plus se burimi i së keqes qëndron tek politizimi i komisioneve zgjedhore si dhe në ndërhyrjet partiake. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe gjatë përsëritjes së zgjedhjeve dh, për ta parandaluar këtë, do të sugjerohim:

- a) KQZ-ja, në zbatim të kompetencave ligjore, nëpërmjet strukturave të saja, të ndjekë nga afër dhe të kontrollojë veprimtarinë e komisioneve zgjedhore me qëllim që ato të zbatojnë me rigorozitet vetëm ligjin.
- b) Të mos lejohet ndërhyrja e partive politike në veprimtarinë e komisioneve.
- c) Të plotësohen vendet vakante në këto komisione.
- d) Të ritrajnohen anëtarët e komisioneve duke përqendruar vëmendjen sidomos në dispozitat ku janë vërejtur shkeljet e ligjit.
- e) Zgjedhjet të monitorohen nga vëzhgues të huaj dhe të vendit.

Do të dëshironim të sillnim në vëmendje të lexuesve që, për propozimin që komisionet e tjera të mos krijoheshin në bazë të propozimeve partiake, t'i referoheshin Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore, miratuar nga Komisioni i Venecias, në datat 5-6 korrik dhe 18-9 tetor 2002⁷. Theksojmë qysh në fillim se ky është një opinion i mbështetur në parimet bazë për një proces zgjedhor demokratik dhe transparent. Në këtë Kod si dhe në udhëzimet shpjeguese të tija paraqitet përvoja pozitive dhe negative si dhe rekomandimet përkatëse. Ky Kod nuk është as rezultat i studimit të legjislacionit zgjedhor të vendit tonë, as përgjithësim i praktikës së zgjedhjeve që janë zhvilluar tek ne.

E theksojmë këtë për të evidentuar faktin e rëndësishëm se e detyrueshme është të zbatohen parimet bazë të procesit zgjedhor, ndërsa problemet tekniko-organizative, madje edhe ato të krijimit të komisioneve zgjedhore duke pasur parasysh kushtet konkrete të çdo vendi, mund të jenë të ndryshme.

Është e vërtetë se në Kodin e miratuar nga Komisioni i Venecias thuhet: "Partitë politike duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në komisionet zgjedhore..", por, në vazhdim të këtij paragrafi, thuhet, gjithashtu: "ose duhet të kenë mundësi të vëzhgojnë punën e organit të paanshëm"⁸.

Kodi i miratuar nga Komisioni i Venecias lë hapësirë për të gjykuar edhe për variantet e tjera duke filluar qysh nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kështu, në të thuhet: "Në vendet ku nuk ka traditë të gjatë të pavarësisë së autoriteteve administrative nga pushteti politik duhet të krijohen komisione elektorale të pavarura dhe asnjansë në të gjitha nivelet, nga niveli kombëtar në nivelin e qendrës së votimit"⁹, ndërsa më poshtë (është fjala për KQZ-në) thuhet: "Ai duhet të përfshijë: të paktën një anëtar të sistemit gjyqësor, përfaqësues të partive që janë në Parlament, një përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, përfaqësues të pakicave kombëtare"¹⁰. Pra, ky Kod paraqet edhe një variant tjetër të përbërjes së KQZ-së.

Për krijimin e komisioneve zgjedhore, në Kodin e miratuar nga Komisioni i Venecias, theksi vihet në realizimin e objektivit që ato të jenë të pavarura dhe të paanshme në të gjitha nivelet. Duke pasur parasysh praktikën e zgjedhjeve në vendin tonë, a mund të thuhet se ky objektiv mund të realizohet nëpërmjet krijimit të komisioneve në bazë të propozimeve të partive politike?!

Kemi mendimin se nuk mund të realizohet. Disa nga argumentet i kemi paraqitur më lart dhe nuk e shohim të nevojshme t'i përsëritim. Vlen të theksohet se nga një studim më i thelluar do të rezultojnë fakte dhe të dhëna të tjera në favor të pikëpamjes se edhe në këtë drejtim Kodi zgjedhor duhet të pësojë ndryshime. Në këtë vështrim, pra, do të sugjerohet që edhe KZZ-të dhe KZQV-të të mos ngrihen në bazë të propozimeve të partive politike përkatëse.

Ç'kritere duhen ndjekur? Ky problem, sigurisht, nuk është i thjeshtë. Mund të zbatohet, për shembull, varianti i testimit që praktikohet për nëpunësit civilë, por, kuptohet, jo identik. Rezervohemi të shfaqim të njëjtin mendim edhe për KQV-të. Jo sepse ato mund të jenë të politizuara, por sepse numri i anëtarëve të këtyre komisioneve në shkallë vendi është i madh (32-33 mijë). Si pasojë, edhe shpenzimet për krijimin e

⁷ Kodi është përkthyer edhe në gjuhën shqipe (34 faqe)

⁸ Po aty, pika 3.1, germa "e", faqe 11

⁹ Pika 3.1, germa "b", faqe 10

¹⁰ Po aty, pika 3.1, germa "e" dhe "d", faqe 10-11

tyre do të ishin të mëdha. Megjithëkëtë, edhe për krijimin e KQV-ve mund të diskutoheshin variante që ta minimizonin ndikimin e tyre nga politika

Duke mbrojtur variantin e krijimit të komisioneve jo në bazë të propozimeve partiake ose të komisioneve të balancuara politikisht, mbështetim kërkesat e Kodit zgjedhor që në këto komisione të ketë përfaqësues të partive politike. Në këtë drejtim kemi parasysh edhe atë që thuhet në Kodin e miratuar nga Komisioni i Venecias që këta përfaqësues “të kenë mundësi të vëzhgojnë punën e vetë organit të paanshëm”.

Megjithëkëtë, nuk pajtohem me pikat 3 dhe 4 të nenit 33 të Kodit zgjedhor ku flitet për përfaqësuesit e partive politike në KQZ: “Përfaqësuesit e shtatë partive politike, të cilat kanë më shumë vende në Kuvend, janë me status të përhershëm pranë KQZ-së. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet që zhvillon KQZ-ja edhe jashtë periudhës zgjedhore”, “Partitë e tjera politike kanë të drejtë të caktojnë jo më herët se 150 ditë dhe jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve dhe deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, përfaqësuesin e tyre të përkohshëm pranë KQZ-së”

Më poshtë po japim disa argumente pse nuk pajtohem me formulimet e mësipërme të nenit 33 të Kodit zgjedhor:

- Në pikën 4 të nenit 154 të Kushtetutës thuhet: “Subjektet elektorale caktojnë përfaqësuesit e tyre pranë komisioneve. Ata nuk kanë të drejtë vote”. Nga kjo del se në Kushtetutë, në këtë rast, përdoret shprehja “subjekt elektorale” dhe jo parti politike.
- Se çfarë duhet kuptuar me nocionin “subjekt elektorale” e gjejmë në nenin 2 të Kodit zgjedhor, të titulluar “Përkufizime”. Në pikën 25 të nenit të mësipërm thuhet: “Subjekte zgjedhore janë partitë politike, koalicionet e regjistruara në KQZ, kandidatët e tyre si dhe kandidatët e pavarur në KZZ ose KZQV”¹¹.
- Neni 33 i Kodit zgjedhor nuk përmend shprehjen subjekt zgjedhor, por “shtatë partitë politike” ose “partitë e tjera politike” që, siç dihet, në Shqipëri janë afro 60.
- Neni 33 nuk e kushtëzon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të partive politike me status të përhershëm ose të përkohshëm, por me detyrimin e regjistrimit të tyre në KQZ, për të cilin bëhet fjalë në nenin 154 të Kushtetutës.
- Derisa neni 154 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e kushtëzon të drejtën e partisë politike për të dërguar përfaqësuesin e vet kur ai është **subjekt zgjedhor**, me dispozita të Kodit zgjedhor atyre nuk mund t’u njihet as statusi i përhershëm dhe as statusi i përkohshëm, në një kohë kur partia që e delegon nuk ka ose ka përfunduar së pasuri statusin e subjektit zgjedhor.

1.2 LISTAT E ZGJEDHËSVE

Një shqetësim tjetër që u konstatua në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 12 tetorit 2003, ishte dhe ai i listave të zgjedhësve. Është pretenduar se në këtë drejtim ka pasur manipulime, se janë lënë me qëllim jashtë listave të zgjedhësve me mijëra zgjedhës. Që ka pasur çrregullime serioze në listat e zgjedhësve, ky është fakt. Që emrat e shumë zgjedhësve nuk kanë figuruar në listat përfundimtare edhe ky është fakt. Por

¹¹ Në vend të shprehjes “elektorale” që përdoret në nenin 154 të Kushtetutës, në nenin 2 të Kodit përdoret shprehja “zgjedhore”, që është e njëjta gjë, është shqipërim.

deri më sot organet kompetente nuk kanë vërtetuar se kjo është pasojë e kryerjes së ndonjë veprë penale.

Duke pasur parasysh edhe përvojën e zgjedhjeve të mëparshme, mund të arrihet në përfundimin se ky problem duhet të shihet më thellë, me objektivitet dhe pa e politizuar atë.

Konkretisht, është e domosdoshme të diskutohet çështja si paraqitet infrastruktura e regjistrimit të popullatës në tërësi dhe e shtetasve që kanë të drejtën për të zgjedhur, në veçanti, domethënë si paraqiten regjistrat e gjendjes civile, regjistri themeltar, ku konsistojnë mangësitë, nëse legjislacioni ekzistues është i plotë ose jo. Veç kësaj, të shihet në ka mekanizma të mjaftueshëm kompjuterizues që të bëjnë të mundur verifikimet dhe kontrollet periodike, të diskutohet se cili duhet të jetë roli dhe detyrat e organeve përkatëse shtetërore lidhur me këtë çështje, cili duhet të jetë raporti midis këtyre organeve dhe komisioneve zgjedhore etj.

Në raportin paraprak interim 4 të periudhës 14-21 tetor 2003 të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it, midis të tjerave, thuhet: “Pasaktësitë në listat e votuesve u shkaktuan kryesisht nga probleme që vijnë nga sistemi i regjistrimit në gjendjen civile, veçanërisht nga mungesa e një sistemi të qendëruar. Kësaj i shtohet edhe ngurrimi i shumë qytetarëve për të informuar autoritetet për ndryshimet e vendbanimit. Misioni i Vëzhguesve të Huaj vëren, gjithashtu, se ndryshimet e bëra në listën e votuesve, pasi ajo u finalizua zyrtarisht, u bënë me kërkesën e PD-së, ndërkohë që një përshtjellim i mëtejshëm u krijua në minutën e fundit të përcaktimit të vendndodhjes së qendrës së votimit”¹².

Në Kodin e miratuar nga Komisioni i Venecias, hartimit të listave të zgjedhësve i është kushtuar rëndësi e veçantë. “Ato, – thuhet në këtë Kod, – janë me rëndësi jetike për garantimin e votimit universal”¹³. Por, në të njëjtin Kod vlerësohet në mënyrë të veçantë interesimi i zgjedhësve. Lidhur me këtë thuhet:

“... është e pranueshme që zgjedhësit të mos përfshihen automatikisht në këto lista, por vetëm me kërkesën e tyre”¹⁴.

Komisioni i Venecias rekomandon:

- Listat e zgjedhësve të jenë të përhershme.
- Të paktën një herë në vit ato duhet të azhurnohen.
- Listat e zgjedhësve duhet të botohen.
- Zgjedhësit duhet të kenë mundësi të kërkojnë korrigjimin e tyre etj.¹⁵.

Listat e zgjedhësve, siç dihet, janë dokumente zyrtare të regjistrimit të zgjedhësve për çdo zonë të qendrës së votimit. Në një kre të veçantë të Kodit zgjedhor (kreu 2) bëhet fjala për procesin e hartimit dhe të rishikimit të listave. Në nenin 55 thuhet: “Zyrat e gjendjes civile hartojnë listat e zgjedhësve sipas dokumentacionit që disponojnë në regjistrat themeltarë të gjendjes civile si dhe në regjistrin e shtetasve me vendqëndrimin në zonën përkatëse të votimit, të evidentuar si të tillë deri pesë muaj para mbarimit të mandatit”, ndërsa në pikën 3 të nenit të mësipërm thuhet: “Kryetari dhe sekretari i bashkisë ose i komunës miratojnë dhe firmosin listën paraprake të zgjedhësve”.

¹² Ky është raporti i fundit paraprak i Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve (MVZ) të OSCE/ODIHR-it.

¹³ Kodi i miratuar nga Komisioni i Venecias, pika 7, faqe 16

¹⁴ Po aty,

¹⁵ Po aty, faqe 6

Është pikërisht kjo listë që, sipas pikës 3 të nenit 55 të Kodit, administrohet nga KQV-ja përkatëse dhe shpallet në çdo qendër votimi.

Nga sa u tha më sipër, del se KZQV-ja futet në lojë (ose fillon të veprojë) fill mbasi i vihet në dispozicion lista e miratuar nga kryetari dhe sekretari i bashkisë ose i komunes. Pas shpalljes së listave paraprake, KZQV-ja bashkëpunon me bashkinë dhe me komunën për të organizuar lajmërimin për çdo zgjedhës duke i krijuar kështu mundësinë për t'u njohur me këto lista dhe për të kërkuar, kur është e nevojshme, korrigjimin e tyre.

Shkaqet për korrigjim janë përcaktuar në nenin 58 të Kodit zgjedhor, ndërsa për të drejtën e zgjedhësve që t'i drejtohen KZQV-së për korrigjimin e listës bëhet fjalë në pikën 2 të nenit 57 të Kodit zgjedhor. Kundër vendimit të KQZ-së, sipas pikës 6 të nenit 57 të Kodit, zgjedhësi ka të drejtë të ankohet në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ndodhet KZQV-ja.

Nëse organet përkatëse kanë respektuar ose jo procedurën e mësipërme ligjore është çështje fakti. Mund të jetë e nevojshme që ky problem të shikohet dhe personat që nuk i kanë respektuar ato të përgjigjen në përputhje me ligjin.

Ajo që tërheq vëmendjen dhe që mendojmë se është mjaft e diskutueshme është përmbajtja e pikës 3 të nenit 58 të Kodit zgjedhor ku thuhet: "Kërkesa për ndryshime në listat paraprake mund të bëjnë edhe partitë politike, subjektet zgjedhore dhe institucione të tjera të interesuara" dhe "Në çdo rast, kërkesat duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës". Në rastet e ndryshimit të vendbanimit ose të vendqëndrimit, kur të dhënat vetjake nuk janë të sakta dhe kur zgjedhësi është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit, "kërkesat e subjekteve të mësipërme duhet të shoqërohen me kërkesën personale të zgjedhësve".

Kuptohet se, si partitë politike, edhe subjektet zgjedhore apo institucionet e tjera të interesuara, kërkesat për korrigjimin e listave duhet t'ua paraqesin KZQV-ve, megjithëse për këtë nuk bëhet fjalë shprehimisht në ligje. Por ajo që është e rëndësishme dhe që kemi mendimin se është thelbi i diskutimit të kësaj dispozite qëndron në faktin se ku do të ankoheshin subjektet e mësipërme kundër vendimit të KZQV-së?! Neni 146 i Kodit zgjedhor nuk lejon ankimin në KQZ, as edhe në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ka qendrën KZQV-ja, sepse, pa autorizimin zyrtar të zgjedhësit, ato nuk mund të paraqiteshin si përfaqësues të tij, domethënë nuk do të ligjësoheshin. Por kjo është njëra anë e problemit. Çështja duhet shtruar dhe duhet zgjidhur në parim. Të drejtën për të kërkuar korrigjimin e listave paraprake mendojmë se duhet ta kishin vetëm zgjedhësit. Veç kësaj, edhe sikur të pranohej për një çast se këtë të drejtë mund ta kishte edhe ndonjë tjetër, nuk do të kishte kuptim që atë ta ushtronin të gjitha partitë politike (domethënë edhe ato që nuk ishin regjistruar në KQZ si subjekte zgjedhore) ose institucionet e tjera që nuk dihet cilat janë. Vlen të përmendet se, në Kodin e miratuar nga Komisioni i Venecias që përmendëm edhe më lart, megjithëse listave të zgjedhësve u kushtohet vëmendje e veçantë, për të drejta të tilla nuk flitet në asnjë rresht apo fjali. Përkundrazi, si figurë kryesore, qoftë për interesimin apo regjistrimin e tij, qoftë edhe për të drejtën e korrigjimit të listës së shpallur, konsiderohet vetëm zgjedhësi.

Dikush mund të pyesë: Ç'të keqe do të kishte? Përse këtë të drejtë të mos e kishin edhe të gjitha partitë politike dhe institucionet e interesuara?

Pyetje të tilla nuk janë të shoqëruara me argumente ligjore. Dëshirat individuale apo interesat e ngushtë partiakë, edhe pse mund të jenë të kuptueshme, nuk duhet t'u japin atyre attribute që nuk ka arsye të kenë. Përkundrazi, mund të ketë raste kur të drejtat që atyre u jep aktualisht Kodi në fuqi të shoqërohen me pasoja të dëmshme për vetë zgjedhësit, pa përjashtuar këtu edhe acarimet e mundshme partiake ose konfliktet

parti – komision zgjedhor. Dukuri të tilla u shfaqën edhe në zgjedhjet e 12 tetorit 2003. Si u procedua në të vërtetë? Deri në datën 15 shtator 2003, sipas disa të dhënave jo të plota të

KQZ-së, 4 subjekte zgjedhore, por kryesisht dy partitë e mëdha, PS dhe PD, u kishin paraqitur KZQV-ve kërkesa për korrigjim listash të zgjedhësve për 37 mijë persona, ndërsa nga vetë zgjedhësit, kërkesa të tilla drejtuar KZQV-ve në shkallë vendi kishin paraqitur vetëm 2160 zgjedhës. Përse kjo diferencë kaq e madhe? Ndoshta duhet të ndodhte e kundërta. Kjo nuk mund të shpjegohet vetëm me interesimin relativisht të paktë të zgjedhësve (gjë që nuk mund të mohohet), por edhe me zellin e madh të subjekteve të mësipërme. Po pse? Që asnjë zgjedhës të mos mbetej pa votuar?! Nuk besojmë të jetë kështu. Partitë politike kanë synuar që, në këtë mënyrë, të garantonin më tepër zgjedhës që do të votonin në favorin e tyre. Nuk besojmë, gjithashtu, që në këto kërkesa të jenë përfshirë edhe zgjedhës që kanë dyshuar se nuk do të votonin në favorin e tyre dhe, aq më tepër, në qoftë se ishin të bindur se zgjedhësi që nuk ishte në listë ishte anëtar apo simpatizant i partisë kundërshtare në garën elektorale. A nuk është element domethënës ajo që thuhet tashti se personat që janë lënë jashtë listës ose personat që figuronin në kërkesat e paraqitura KZQV-ve për korrigjimin e listave do të votonin në favor të kësaj ose asaj partie?!

Problem tjetër që ka lidhje me këtë çështje është edhe fakti se KZQV-ja nuk është e detyruar të miratojë çdo kërkesë të partive politike për korrigjimin e listave paraprake të zgjedhësve. Çfarë bëhet? Si veprohet në rastet kur mund të merren vendime refuzimi, qoftë edhe pjesërisht?

Partia politike, për arsyet që përmendëm më lart, nuk është ankuar në gjykatë. Po zgjedhësit, a janë njoftuar një e nga një për vendimin e refuzimit? Në qoftë se jo, a kanë përgjegjësi (qoftë edhe moralisht) partitë politike që u hoqën zgjedhësve mundësinë e ankimit në gjykatë?

Nuk përjashtohet edhe mundësia që zgjedhësit, të bindur se këtë çështje do ta ndiqnin partitë politike, e kanë fjetur mendjen dhe kanë menduar se emri i tyre do të figuronte në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Ja, pra, edhe një pasojë tjetër e dëmshme që mund të ketë privuar zgjedhësin nga e drejta e votimit. Në përfundim, kemi mendimin se ky është një problem serioz që vlen të diskutohet me objektivitet duke iu referuar fakteve. Ajo që duhet bërë në të ardhmen nga të gjithë, pra edhe nga forcat politike, është intensifikimi i punës konkrete për sensibilizimin e zgjedhësve që të tregojnë më tepër interes për t'u njohur me listat e zgjedhësve dhe, kur është rasti, të ankohen në kohën e duhur në gjykatë.

Lidhur me listat e zgjedhësve, pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor të gjykatës së apelit për përsëritjen e zgjedhjeve në 130 qendra votimi të Tiranës, është ngritur një çështje që mendojmë se kërkon sqarim dhe përgjigje ligjore. Duke pasur parasysh faktin, siç pretendohet, se në zgjedhjet e 12 tetorit 2003 janë lënë jashtë listave të zgjedhësve një numër relativisht i konsiderueshëm zgjedhësish të cilët, si pasojë, më 12 tetor nuk kanë mundur të votojnë, kërkohet që KQZ-ja, me një akt nën-ligjor, të urdhërojë KZQV-të përkatëse të Tiranës që, në bazë të kërkesave të subjekteve zgjedhore, në listat e zgjedhësve të shtohen zgjedhësit që nuk votuan në 12 tetor 2003 me qëllim që ata të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtën e votës më 28 dhjetor 2003, ditën e caktuar për përsëritjen e pjesshme të votimeve.

Kemi mendimin se kjo kërkesë nuk është e ligjshme, sepse listat e mëparshme nuk mund të ndryshohen, pavarësisht nga defektet që mund të kenë pasur ato. (Nuk

përrjashtohet mundësia që pasaktësi të listave të ketë pasur edhe në disa qendra votimi ku zgjedhjet janë përsëritur, por edhe në qendrat e votimit ku rezultati i tyre është konsideruar i ligjshëm). Si rrjedhim, korrigjimet në listat do të cenonin integritetin e zgjedhjeve me pasoja të dëmshme dhe kontestime serioze.

KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor, siç dihet, kanë të drejtë të shpallin të pavlefshme zgjedhjet në qendra votimi, në njësitë zgjedhore ose në gjithë vendin. Për marrjen e këtij vendimi, shkaku kryesor mund të ishte shkelja e ligjit që mund të ketë ndikuar në përcaktimin e kandidatit fitues (neni 117, pika 1, i Kodit zgjedhor). Në marrjen e këtyre vendimeve, KQZ-ja dhe Kolegji zgjedhor kanë parasysh nenet 109, 110 dhe 117 të Kodit zgjedhor dhe jo faktin nëse në listat e zgjedhësve, për arsye të ndryshme, nuk ishin përfshirë këta apo ata zgjedhës, ose ky apo ai numër zgjedhësish që pretendohet.

Shkaqet për ndryshime në listat paraprake të zgjedhësve janë përcaktuar në nenin 58 të Kodit, që i përket fazës së hartimit dhe të rishikimit të listave dhe jo shqyrtimit të ankesave për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kodi zgjedhor nuk parashikon korrigjim të listave pas vendimit për përsëritjen e zgjedhjeve, por vetëm përsëritjen e tyre jo më shumë se pas 4 javëve. Nuk është harresë e ligjvënësit që, në Kodin zgjedhor, nuk është parashikuar korrigjim (shtesa apo heqje) i listave edhe pas vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Në këtë vështrim, KQZ-ja nuk ka të drejtë të urdhërojë që në listat ekzistuese të bëhen shtesa të zgjedhësve që nuk kanë votuar. Lëshimi i një udhëzimi të tillë do të krijonte normë të re ligjore, gjë që nuk është në kompetencën e KQZ-së.

Më sipër, për përsëritjen e zgjedhjeve, përmendëm shifrën 130 qendra votimi. Në të vërtetë, sipas zëdhënësit të KQZ-së, zgjedhjet do të përsëriten në 118 qendra votimi (ky ishte gabim material i lejuar nga Kolegji Zgjedhor i gjykatës së apelit). Zëdhënësi i KQZ-së, në përgjigje të kërkesës për korrigjimin e listave me të cilat u votua më 12 tetor 2003, theksoi: "Parregullsitë në listat do të trajtohen në bazë të Kodit zgjedhor dhe të akteve të tjera nënligjore".

KREU II

VËREJTJE DHE SUGJERIME PËR DISPOZITA TË VEÇANTA TË KODIT ZGJEDHOR

1.Për nenin 6 të Kodit zgjedhor

Në këtë nen thuhet se aparati i Këshillit të Ministrave dhe i kryeministrisë, të gjitha ministritë, prefekturat dhe bashkitë janë të detyruara të caktojnë nëpunës ndërlidhës. “Në rast se ndonjëri nga këto institucione nuk cakton nëpunësin e vet ndërlidhës, në përputhje me kërkesat dhe brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, atëherë titullari i insitucionit përkatës konsiderohet se ka marrë përsipër funksionimin e nëpunësit civil”.

Kemi mendimin se kjo zgjidhje nuk është as e drejtë dhe as efektive, sepse është vështirë të realizohet. Për të mundësuar emërimin e nëpunësit ndërlidhës mund të ndiqej një procedurë tjetër.

2.Për nenin 20 të Kodit zgjedhor

Në këtë nen, që përcakton kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të KQZ-së, në pikën 2 të tij , germa “ç”, thuhet: “Të mos ketë qenë punonjës i shërbimit informativ shtetëror ose i Policisë së Shtetit në 5 vitet e fundit”. Për miratimin e kësaj dispozite mendojmë se duhet të jepeshin argumente. Cilat janë rezervat apo dyshimet? Përse kjo kushtëzohet me qenien e tyre 5 vitet e fundit në këto organe, kur dihet se ato janë të depolitizuara? I njëjti qëndrim duhet mbajtur, për shembull, edhe në rastet kur ky apo ai punonjës ka punuar 2–3 vjet në këto organe dhe, më vonë, është emëruar me detyra të tjera, p.sh., në organet e prokurorisë, të gjykatës, të administratës publike etj.?

E shohim të nevojshme të përmendim se një dispozite e tillë përjashtuese nuk ka ekzistuar në Kodin e shfuqizuar.

Ky problem mendojmë se duhet të shihet në aspektin e të drejtave të shtetasve në një shoqëri demokratike.

Veç kësaj, për sa i përket pikës 3 të nenit 20, që përmendëm më lart, mbas asaj që thuhet se “Anëtari i KQZ-së duhet të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet”, mendojmë se duhet të shtohen fjalët: “në njërën nga fushat e mëposhtme” (formulimi i pikës 1 të nenit 16 të Kodit të shfuqizuar, ku bëhej fjalë për të njëjtën çështje, ishte më i plotë).

E themi këtë sepse, nga formulimi i nenit 20 të Kodit zgjedhor kuptohet sikur ai duhet të ketë përvojë në të gjitha fushat që përmenden në pikën 3 të nenit 20 të Kodit Zgjedhor. Këtë e përmendim vetëm për saktësi, sepse, në të vërtetë, nënkuptohet.

3.Për procedurat e marrjes së vendimeve

Për herën e parë, në Kodin e ri zgjedhor është përcaktuar procedura se, në marrjen e vendimeve (të shumicës së vendimeve), kërkohet votim pro i pesë anëtarëve. Kjo procedurë zbatohet për të gjitha komisionet duke filluar nga KQV-ja deri në KQZ. Praktika e zgjedhjeve të 12 tetorit 2003 vërtetoi në mënyrë evidente se kjo kërkesë ligjore

ishite bllokuese, pjesërisht ndoshta edhe e qëllimshme. Prandaj do të sugjerim që këto dispozita të rishikoheshin.

4.Për nenin 27 të Kodit zgjedhor

Në këtë nen, që bën fjalë për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të KQZ-së, në pikën 2 të tij, thuhet se kryetari i KQZ-së zgjidhet për një periudhë 3.5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. E njëjta gjë thuhet edhe për zëvendëskryetarin. Kemi mendimin se këto dispozita duhet të shihen. E themi këtë sepse KQZ-ja është organ kushtetues dhe ligjvënësi, në nenin 154 të Kushtetutës, nuk përmend fare, as zgjedhjen e kryetarit, as zgjedhjen e zëvendëskryetarit. Në qoftë se do t'i referoheshim nenit 125 të Kushtetutës ku

flitet për përbërjen e Gjykatës Kushtetuese (Gjykata Kushtetuese është, gjithashtu, organ kushtetues), thuhet se Gjykata Kushtetuese përtëritet çdo tre vjet dhe se kryetari i saj emërohet për një periudhë prej 3 vjetësh.

Për sa i përket zëvendëskryetarit të KQZ-së, megjithëse disa ditë para votimit të 12 tetorit u shtrua çështja e zgjedhjes së tij, ajo u shty për një periudhë të pacaktuar. Arsyet, siç duket, ishin të natyrës politike me arsyetimin se KQZ-ja nuk është e balancuar politikisht. Kemi mendimin se zëvendëskryetari duhet të ishte zgjedhur duke iu referuar nenit 29 të Kodit zgjedhor të shfuqizuar (megjithëse për këtë duhet të ishte parashikuar dispozitë transitore). Si do të veprohet në qoftë se edhe në zgjedhjet e tjera nuk do të arrihet “balancimi politik”? KQZ-ja do të vazhdojë të mbetet pa zëvendëskryetar kur, veç të tjerave, sipas pikës 5 të nenit 30 të Kodit dihet se “vendimet nënshkruhen domosdoshmërisht nga kryetari dhe nga zëvendëskryetari”.

Për çështjet e mësipërme kemi mendimin se mund të zgjidhen me konsensus, por në përputhje me Kushtetutën dhe me frymën e saj (në qoftë se çmohet e nevojshme, dispozitave ligjore mund t'u bëhen ndryshimet përkatëse). Por, siç duket, edhe në formulimin e dispozitave të mësipërme është pasur parasysh synimi që balancimi politik të shtrihet edhe në organizimin e brendshëm të KQZ-së.

5.Për nenin 34, pika 10, dhe nenin 40, pika 10, të Kodit

Në rastin e parë thuhet: “KZZ-ja ringrihet në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin, jo më vonë se një muaj pas shpalljes të rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja”, ndërsa në rastin e dytë thuhet: “KZQV-ja ringrihet në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për këshillin vendor, jo më vonë se një muaj pas shpalljes të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve vendore nga KQZ-ja”.

Jemi të mendimit se këto dy nene duhet të rishikohen për të mos mbetur formale. Afate të tilla nuk janë zbatuar edhe më parë. Në ndërtimin e dispozitave të tilla ndoshta duhet të kihet parasysh mundësitë dhe kushtet tona konkrete. Jemi dëshmitarë për ngritjen me vonesë të KZQV-ve dhe të KQV-ve në prag të zgjedhjeve edhe për faktin se partitë politike përkatëse nuk ishin korrekte në respektimin e afateve për paraqitjen e propozimeve.

6.Për nenin 80 dhe 81 të Kodit zgjedhor

Në këto nene flitet për detyrimin e kandidatit për të paraqitur listën e zgjedhësve me nënshkrimin e 300 zgjedhësve (për kandidatët për deputetë), ndërsa për kandidatët për zgjedhjet vendore kjo listë varion nga 50 në 300 zgjedhës. Vëzhguesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si në zgjedhjet e 12 tetorit 2003, edhe në zgjedhjet e mëparshme, kanë konstatuar se nuk bëhen verifikime lidhur me nënshkrimin e zgjedhësve në këto lista. Kjo është arsyeja që na bën të sugjerojmë se në këto dispozita duhet të përcaktohet edhe detyra e verifikimit të këtyre listave, ndryshe kjo kërkesë ligjore do të mbetet formale. Ka interes të përmendet këtu ajo pjesë e Kodit të miratuar nga Komisioni i Venecias ku flitet për paraqitjen e kandidaturave. Në të thuhet: “Paraqitja e kandidatëve individualë ose e listave të kandidatëve mund të kushtëzohet me mbledhjen e një numri minimal firmash” dhe, më poshtë: “Verifikimi i firmave duhet t’u nënshtrohet rregullave të qarta, veçanërisht për sa u përket afateve” se “procesi i verifikimit, në parim, duhet të bëhet për të gjitha firmat”¹⁶.

7.Për nenin 103 të Kodit (Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë)

Kemi mendimin se kanë mbetur dhe ndoshta do të mbeten formale pikat 6, 8 dhe 9 të dispozitës së mësipërme ku bëhet fjalë për të drejtën e zgjedhësve që nuk mund të votojnë vetë, që të kërkojnë nga KZQV-ja regjistrimin e tyre, duke paraqitur për këtë edhe dokumentacionin zyrtar, që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Për zgjedhësit e verbër thuhet se qendrat e votimit mund të pajisen me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur.

Realizimi në praktikë i kësaj dispozite do t’u përgjigjej standardeve ku synohet të arrihet, por, në kushtet e vendit tonë, kjo e drejtë ose kjo mundësi, për shumë arsye, vështirë të bëhet realitet, sepse zgjedhësi nuk e ka të lehtë të sigurojë dokumentacionin përkatës dhe, pas kësaj, t’i drejtohet KZQV-së. Veç kësaj, ai e di që mund të votojë në qendrën e votimit edhe pa këto dokumente, me ndihmën e një zgjedhësi tjetër. A jemi ne në gjendje, aktualisht, të sigurojmë pajisjet dhe mjetet e posaçme që do të ndihmonin zgjedhësin e verbër për të lexuar ose për të kuptuar fletën e votimit?

8.Për nenin 104 (Ruajtja e rendit në qendrën e votimit)

Thuhet se, kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja vendos pezullimin e votimit dhe kërkon ndihmën e policisë. Kërkesa në këtë rast paraqitet me shkrim dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave. Kjo kërkesë nënshkruhet nga kryetari dhe zëvendës-kryetari i KQV-së. Mendojmë se, në praktikë, mund të ndodhin raste të tilla, në të cilat mund të mjaftonte edhe vetëm një kërkesë e kryetarit të KQV-së. Është fjala për rastet e ngutshme.

Në këtë drejtim mendojmë se duhet të kihet parasysh ajo që thuhet edhe në Kodin e miratuar nga Komisioni i Venecias: “Çdo ligj elektoral duhet të parashikojë ndërhyrjen e forcave të sigurimit”¹⁷ në rastin e incidenteve. Në një rast të tillë, kompetencën për të thirrur policinë duhet ta ketë vetëm kryetari i komisionit të qendrës së votimit. Është e rëndësishme të mos lejohet që këtë kompetencë ta kenë të gjithë

¹⁶ Kodi i miratuar nga Komisioni i Venecias, pika 1.3, “Paraqitja e kandidatëve”, faqe 6

¹⁷ Është fjala për forcat që garantojnë rendin, domethënë sigurinë

anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, sepse ajo që nevojitet në rrethana të tilla është marrja menjëherë e vendimit, i cili nuk duhet të diskutohet¹⁸.

9. Për nenin 140 të Kodit Zgjedhor

Në këtë nen, ku flitet për fushatën zgjedhore në radiot dhe televizionet private, thuhet: “KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimeve të operatorit radioteleviziv ...” dhe përsëri më poshtë: “Në rast shkeljeje, KQZ-ja urdhëron KKRT-në ...”.

Kemi mendimin se një urdhër i tillë nuk duhet t’i drejtohet një organi të zgjedhur nga Kuvendi. Veç kësaj, vetë KKRT-ja nuk është organ ekzekutimi. Vlen të përmendet se KKRT-ja, kur merr vendime në funksion të kryerjes së detyrave të veta, ia dërgon ato për ekzekutim organit përkatës.

Prandaj kjo pjesë e këtij neni ka vend të rishikohet dhe vendimi i KQZ-së të jetë i detyrueshëm për t’u zbatuar nga organi përkatës i ekzekutimit të vendimeve të tilla.

10. Për fondet në dispozicion të partive politike (neni 145)

Duke pasur parasysh shqetësimet dhe vonesat e vërtetuara në zgjedhjet e 12 tetorit 2003, mendojmë se kjo dispozitë duhet të jetë më e qartë për sa u përket jo vetëm ndarjeve të fondeve në kohën e duhur, para fillimit të fushatës zgjedhore, por ndoshta duhet të rishikohet edhe përqindja sidomos në favor të partive më të vogla duke krijuar kështu mundësi më të mëdha për një fushatë më të ekuilibruar në krahasim me partitë e mëdha.

11. Për ankimet që shqyrtohen nga KQZ-ja

Kemi mendimin se KQZ-ja, për të lehtësuar dhe për të mos zvarritur këtë procedurë, duhet të ketë një rregullore të përcaktuar qartë (pa penguar të drejtën e palëve pjesëmarrëse në paraqitjen e provave dhe të pretendimeve), por diskutimet e zgjatura dhe debatet e acaruara nuk i shërbejnë çështjes. Veç kësaj, nuk ka si të konceptohet praktika e ndjekur nga KQZ-ja, anëtarët e së cilës pozicionohen publikisht edhe për vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e kësaj apo asaj prove dhe votojnë, po publikisht, për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve objekt shqyrtimi, pa u tërhequr për vendim. Kjo praktikë, mendojmë se nuk ka të bëjë me transparencën. Përkundrazi, duke pasur parasysh që edhe KQZ-ja është një lloj gjykate e pavarur që vepron në mënyrë kolegjiale, nuk duhet ta bëjë publike votën e secilit anëtar, para se të vendosë. Sikur të ndodheshim në një sallë gjyqi, palët në proces do të kishin të drejtën të kërkonin përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj mendojmë që, për të parandaluar pasojat e dëmshme të kësaj praktike, në Kodin zgjedhor duhet të përmendet që, mbas shqyrtimit të gjithanshëm të çështjes, KQZ-ja tërhiqet për të marrë vendim. Në mbështetje të këtij mendimi është edhe ajo që përmendet në pikën 1 të nenit 160 të Kodit zgjedhor ku thuhet: “Vendimi i KQZ-së është gjithmonë i formës së shkruar”. A mund të shkruhet ky vendim në prani të subjekteve që ankohen, të përfaqësuesve të partive politike dhe të të tjerëve të pranishëm në mbledhjet e KQZ-së? Sigurisht, jo.

Kemi mendimin, gjithashtu, që në Kodin zgjedhor të përmendet shprehimisht e drejta e KQZ-së që, sipas rastit, të shpallë edhe rezultatet e pjesshme. Është fjala për ato

¹⁸ Pika 3.6, “Siguria”, 112, faqe 34

raste kur provat vlerësohen të plota dhe të pakontestueshme. Natyrisht, kjo nuk e pengon ankimin e subjektit përkatës në Kolegjin Zgjedhor të gjykatës së apelit.

12. Për përbërjen e Kolegjit Zgjedhor të gjykatës së apelit, Tiranë (neni 163)

Kemi mendimin se nuk është e drejtë ajo që thuhet në këtë dispozitë se: “secili prej përfaqësuesve të dy partive parlamentare të maxhorancës dhe dy partive parlamentare të opozitës, që kanë përkatësisht numrin më të madh të mandateve në Kuvend, ka të drejtën të përjashtojë një prej tetë emrave të nxjerrë nga kutia e shortit”, se “asnjë prej partive të tjera nuk ka të drejtën e kundërshtimit”, se “procedura për përjashtimin e emrave është e fshehtë”, se “kërkesa për përjashtim përmban vetëm emrin e gjyqtarit, pa përmendur shkaqet e përjashtimit”.

Është pozitive që zgjedhja me short është publike dhe në prani të përfaqësuesve të partive politike dhe të medias, por nuk mund të kuptohet që partitë politike të ndërhyjnë dhe të përjashtojnë një prej tetë emrave të nxjerrë nga kutia e shortit. Nuk e dimë a ka përvoja të tilla në vende të tjera demokratike. Në fund të fundit edhe kjo gjykatë është e pavarur, është pjesë e sistemit gjyqësor edhe pse është krijuar për të shqyrtuar ankimet zgjedhore.

Mendojmë, gjithashtu, se edhe betimi që parashikohet në pikën 46 të dispozitës së mësipërme është i tepërt. Një gjyqtar që është betuar njëherë, nuk është e nevojshme të betohet përsëri. Betimi i dytë nuk e rrit përgjegjësinë e gjyqtarit. Përmbajtja e kësaj dispozite nuk mund të justifikohet me faktin se në këtë mënyrë krijohet besimi i partive politike ndaj gjyqtarëve që do të shqyrtojnë ankimet e subjekteve zgjedhore.

Gjithashtu, nuk na duket e përshtatshme ajo që thuhet në pikën 5 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor se: “kohëzgjatja në detyrë e Kolegjit Zgjedhor të dalë nga ky short vazhdon deri në dekretimin e datës së zgjedhjeve të radhës për në Kuvend, për të cilat hidhet një short i ri”.

Së pari, sepse ndryshimi i shpeshtë në përbërjen e Kolegjit Zgjedhor mendojmë se nuk do t'i shërbente rritjes së përvojës profesionale në këtë fushë dhe, *së dyti*, sepse nga formulimi i dispozitës së mësipërme del se shorti tjetër mund të hidhet edhe pas dekretimit të zgjedhjeve të ardhshme të organeve të qeverisjes vendore. Prandaj, do të ishte mirë që edhe kjo dispozitë të ishte objekt diskutimi.

13. Për nenin 161 të Kodit zgjedhor

Në këtë nen thuhet: “Gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor nuk mund t'i nënshtrohet procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar Kolegji”. Mendojmë se një mbrojtje e tillë ligjore nuk është e drejtë, sepse i vë këta gjyqtarë në pozita të privileguara në krahasim me gjyqtarët e tjerë. Nuk do të kishte kuptim ose nuk do të ishte e justifikueshme të shmangej procedimi disiplinor i këtij gjyqtari, vetëm sepse ai është ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të KQZ-së. Në fund të fundit, edhe këta janë gjyqtarë si gjithë të tjerët. Ndryshe është ajo që thuhet në pjesën tjetër të kësaj dispozite për moslëvizjen e tij nga detyra e gjyqtarit për shkaqe që lidhen me pikën 5 të nenit 57 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sepse lëvizjet e gjyqtarëve të kësaj gjykate mund të shoqërohen me pasoja të dëmshme.

14. Për formën dhe përmbajtjen e ankimit (neni 169)

Mendojmë se ka vend të diskutohet ajo që thuhet në këtë dispozitë se, në qoftë se ankuesi nuk bën kundërshtim për përjashtimin e gjyqtarit në çastin e paraqitjes së ankesës, atëherë ai nuk ka më të drejtë ta kundërshtojë këtë gjyqtar. Praktika ka vërtetuar se të dhënat që mund të përbëjnë bazë për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, mund të rezultojnë edhe më vonë, domethënë pas paraqitjes së ankesës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për nenin 170 të Kodit zgjedhor ku thuhet: “Nëse pala e interesuar nuk e bën kundërshtimin brenda dy ditëve nga marrja e njoftimit të ankimit, atëherë ajo nuk ka më të drejtë të kundërshtojë ndonjë gjyqtar”.

15. Për pikën 1 të nenit 173 të Kodit zgjedhor

Në pikën 1 të nenit 173 të Kodit zgjedhor thuhet: “Kolegji Zgjedhor gjykon dhe vendos për ankimet brenda shtatë ditëve nga depozitimi i ankimit”. Duke pasur parasysh rëndësinë që kanë afatet sa më të shkurtra të ankimeve, që lidhen me procesin ose ankesat zgjedhore, kemi mendimin se ky afat mund të reduktohej deri në pesë ditë dhe, në çdo rast, vendimi të ishte i shkruar (i arsyetuar).

16. Për trajnimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore

Në të gjitha zgjedhjet janë konstatuar defekte serioze në trajnimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore. Kjo ka ardhur për shumë arsye, si:

- moskrijimi i tyre në kohë;
- përzgjedhja e tyre ose propozimet jo në bazë të përgatitjes kulturore, arsimore dhe profesionale, por të “vendosmërisë” ose të militantizmit në mbrojtje të interesave partiakë. Për këtë problem do të sugjerim që, në të ardhmen, të diskutohej seriozisht.

Kjo, sigurisht, ka të bëjë me faktin nëse do të vazhdohet me komisionet e formuara në bazë të propozimeve të partive politike apo të zbatoheshin edhe variante të tjera për t'i bërë ato të pavarura dhe të paanshme. Por, sidoqoftë, përvoja e derisotshme krijon bindjen se nevojitet më shumë kohë për trajnimin e anëtarëve të komisioneve. Veç kësaj, me ligj, nuk duhen lejuar lëvizjet apo tërheqjet e shpeshta, sidomos para ditës së votimit, siç ka ndodhur edhe në zgjedhjet e 12 tetorit 2003. Sigurisht, përjashtime mund të ketë.

17. Për përcaktimin në ligje të rasteve kur ankesat e zgjedhësve në gjykatë paraqiten edhe pas shpalljes së listave përfundimtare, por jo ditën e zgjedhjeve.

Mendojmë se duhet të shihet mundësia për përcaktimin në ligje të këtyre rasteve. Kështu, për shembull, me gjithë kërkesën për korrigjimin e listës paraprake, KZQV-ja nuk ka marrë vendim ose ka marrë vendim pas shpalljes së listave përfundimtare etj. Në këto raste ankimi mund të shqyrtohej në gjykatë jo më vonë se 5 ditë para ditës së zgjedhjeve.

18. Për votimin e shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit

Ndoshta e vlente të diskutohej edhe çështja e votimit të shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit. Më demokratik dhe gjithëpërfshirës do të ishte votimi në vendet ku ata ndodhen. Aktualisht, kjo do të ishte e vështirë të realizohej, por edhe kështu siç është sot, listat do të kenë pasaktësi dhe të dhënat për pjesëmarrjen në total të zgjedhësve të regjistruar do të jenë të cinguara. Vlen të përmendet, gjithashtu, se ata që vijnë nga jashtë për të votuar 2-3 ditë para zgjedhjeve ose ditën e zgjedhjeve mund të privohen nga e drejta e zgjedhjes për shkak të pasaktësisë së të dhënave vetjake në këto lista që duheshin korrigjuar brenda afatit të caktuar ligjor. Kemi parasysh se komisionet e votimit edhe për zgjedhësit me banim jashtë shtetit dhe që kthehen për të votuar janë të detyruara të zbatojnë procedurat përkatëse të Kodit zgjedhor, si për të gjithë zgjedhësit e tjerë.

19. Për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve

Shqyrtimi i ankesave për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve ka rëndësi të veçantë. Në pikën 4 të nenit 117 të Kodit përdoret shprehja “personi i interesuar” dhe “gjykatë kompetente”. Mendojmë se duhet të bëhet e qartë kush përfshihet në personat e interesuar dhe cila është gjykata kompetente. Veç kësaj, afati 10- ditor mund të reduktohej, p.sh., në 5 ditë. Për vetë rëndësinë që ka shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve mund të diskutohej çështja që për rastet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në njësitë zgjedhore (sidomos në zgjedhjet parlamentare) ose në të gjithë territorin e Republikës, ankimi ndaj vendimit të KQZ-së të bëhet në Gjykatën e Lartë ose vendimet e Kolegjit Zgjedhor, në rastet e mësipërme, të ankimoheshin edhe në Gjykatën e Lartë.

20. Për nenin 131, germa “e” e Kushtetutës

Në Kodin Zgjedhor mendojmë se mund të përmendet edhe kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar dhe për të vendosur për çështjet që kanë të bëjnë me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre (neni 131 germa “e” e Kushtetutës).

*
* *

Ky punim do të ishte më i plotë dhe më i argumentuar në qoftë se do të ishim njohur edhe me raportin përfundimtar të OSCE/ODIHR-it për zgjedhjet e 12 tetorit 2003. Shpresojmë se në këtë raport do të paraqiten edhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor.

Në këtë punim patëm parasysh edhe mendimet e shfaqura nga disa specialistë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, vëzhgues në zgjedhjet e 12 tetorit 2003, në një tavolinë të rrumbullakët, të organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, më 22 nëntor 2003.

Disa nga defektet e Kodit zgjedhor që përmenden në këtë punim, mendojmë se kanë të bëjnë me faktin se jo vetëm para hartimit të projektit, por edhe pas përfundimit të punës nga komisioni dypalësh parlamentar projekt-kodi zgjedhor nuk u bë objekt diskutimi dhe debati në një rreth të gjerë specialistësh. Siç dihet, projekt-kodi i ri u dërgua menjëherë për miratim në Kuvend.

Kemi mendimin se nga kjo praktikë negative duhet të mësojmë. Për këtë, paraprakisht, do të parashtronim këtë sugjerim:

Në qoftë se do të duhej që Kodi zgjedhor të pësonte ndryshime, mbasi të përcaktoheshin në ç'drejtime duhet të ishin ato, me nismën e Kuvendit, kjo detyrë t'i besohet një grupi specialistësh me përvojë në këtë fushë dhe të paangazhuar në partitë politike. Pas kësaj, Kuvendi apo komisionet përkatëse parlamentare, mbi këtë bazë, të vlerësonin dhe të vendosnin nëse ishte e nevojshme të bëheshin përmirësime të mëtejshme. Do të ishte e rekomandueshme që kjo punë të fillonte menjëherë dhe të respektoheshin rigorozisht afatet e caktuara.